

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje dhe Shërbim Vendosije Bileta në Sistemet e Parkimit

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Bileta: 22459000-2, Shërbime Instalimi (me përjashtim të softuerit): 51000000-9, Shërbimet e Parkimit: 98351100-9, Shërbime të ndryshme të biznesit: 799900000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,982,549 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzetë e nëntë) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit që prokurohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohehet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...].3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me te vogel se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2. Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues i biletave, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi për mallin Bilete Elektronike të tipit "fanfold" dhe "rulon", objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit / distributorit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1

Njësia e prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti Kontraktor duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për origjinën e mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 9001:2015** ose ekuivalent, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur **nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet Standartizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, rrjedhimisht është e drejta e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standartizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001:2015 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një game të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë I menaxhimit për cilësinë nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menxhimit (për prodhim, ofrimin të

shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, vperime korigjuese dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi I saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesi një vërtetim të lëshuar nga organet përkatëse (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar minimalisht për 3 (tre) muajt e fundit, i cili duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se **5 (pesë) punonjës**, e shoqëruar dhe me listëpagesat (formulari E-SIG 025) për periudhën e sipër përmendur. Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojme se jemi bazuar në specifikimet teknike të procedurës me objekt: **“Blerje dhe Shërbim Vendosije Bileta në Sistemet e Parkimit”**.

Numri i punonjësve të siguruar minimalisht për 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër të kutisë së biletave elektronike ku në brendësi të ketë një sasi minimale prej **100** (një qind) **copë** bileta elektronike të tipit “fanfold” të pandërprera në ambjentet e AK. Operatorët ekonomikë ofertues mund të sjellin dhe mostër të kutisë së pahapur me kapacitet maksimal prej **5000** (pesë mijë) **copë** biletash elektronike brenda tyre. Gjithashtu për tipin e biletës rulon duhet të paraqitet minimalisht një mostër e rrulit me një sasi gjeneruese minimale prej **1000** (një mijë) **copë** bileta elektronike të tipit “rulon” të pandërprera në ambjentet e AK. Operatorët ekonomikë ofertues mund të sjellin dhe mostër të rrulit me kapacitet të plotë prej **6000** (gjashtë mijë) **copë** biletash elektronike

rulon.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë:

- **Mostër “emri i artikullit”,**
- **Datën e zhvillimit të tenderit,**
- **Emrin e ofertuesit,**
- **Nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.**

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Argumentimi: *Ky kriter u vendos bazuar, Nenit 40, pika 6, a të VKM-së NR. 285 datë 19.05.2021 ”për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike “Blerje bileta Elektronike për Sistemet e Parkimit”

Tirana Parking me anë të kësaj procedure prokurimi synon të blejë Bileta parkimi për Sistemet e Parkimit në sheshparkime, parkime nëntokësore dhe terminale të autobusave nën administrimin e saj në Tiranë. I bëjmë me dije operatorëve ekonomikë se sistemet e parkimit janë sisteme “CAME PARKARE PKE” dhe biletat e parkimit duhet të jenë të kompatibël me këtë sistem.

Duke qenë se sistemet e parkimit si më poshtë:

1. Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë - (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).
2. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”).
3. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (“Kompleksi Malajzian”).
4. Sheshparkimi nëntokësor – (Sheshi “Skënderbej”).

kanë printer i cili suporton biletën të tipit “fanfold”, nevojitet që këto të fundit të kenë specifikimet si më poshtë vijon:

Specifikimet teknike

- Formati: 53,80 x 86.5 mm,
- Prerje me formë dhe bileta të vazhduara,
- Paketimi 5000 copë bileta të pandërprera,
- Të jenë të ambalazuara me karton dhe me qese ku të jetë e mbyllur hermetikisht (vakum) sipas formës së paketimit të kartonit,
- Paketimi të jetë me njoftim për fundin e stokut,
- Trashësia e biletës: 231 mikrometër,
- Pjesa termike 211 gr/m²,
- Temperatura e djegies së letrës termike 40°C me ndryshim 85°C,
- Bileta në njërën anë do të jetë në ngjyrën e vetë letrës (e bardhë)




Figura 1. Përmasat e biletës elektronike termike fanfold

Në mënyrë që të shfrytëzohet maksimumi i kapacitetit mbajtës të makinerive të gjenerimit të biletave elektronike (5000 bileta), është përcaktuar që kutia e cila mban ato duhet të ketë përmasat si në figurën 2, të paraqitur më poshtë.

Kjo tip kutie e cila mban sasinë totale të biletave fanfold me 3 (tre) palosje mund të futet tërësisht në makineritë e sistemeve të reja të parkimit pa e prerë atë në pjesë.




Figura 2. Përmasat e kutisë së biletave elektronike

Duke qenë se sistemet e parkimit:

1. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Qytet Studenti”).
2. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).
3. Terminali Nr. 2 i Autobuzave të Juglindjes – (“Qytet Studenti”).
4. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Avni Rustemi”).
5. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).
6. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).
7. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).
8. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (“Bulevardi i Ri”).
9. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (“Kopshti Zoologjik”).

kanë printer i cili suporton biletën të tipit “rulon”, nevojiten bileta elektronike të tipit rulon të cilat janë paraqitur në figurën 3. Këto bileta elektronike gjenerojnë një numër mesatar prej 6000 biletash elektronike të cilat duhet të kenë specifikimet teknike si më poshtë:

- Biletë termike e vazhduar me kapacitet maksimal gjenerimi prej 6000 biletash,
- Dimensionet: 80x200x25.4 (mm),
- Spesori: 105µm,
- Të jenë të ambalazuara me karton dhe me qese ku të jetë e mbyllur hermetikisht sipas formës së paketimit rulonit.
- Pjesa termike e rullit të jetë në anën e jashtme të rulonit.
- Të kenë lajmërim për fundin e stokut.
- Diametri i qendrës së mbajtësit të rullit, 25mm (pa vetë trashësinë e mbajtësit).



Figura 3. Përmasat e rulonit të biletave elektronike

Duke qenë se sheshparkimet, parkimet nëntokësore dhe terminalët e autobuzave me shërbim 24 orë në 7 ditë të javës nën administrimin e Tirana Parking të cilat kanë sistem parkimi kanë arritur në 13 (trembëdhjetë) dhe me shtimin e parkimit tek “Garda” i cili është në plan për tu bërë me sistem parkimi, është bërë e pamundur ndjekja e tyre për vendosje biletash në kohë me stafin e limituar prej 1 (një) personi që disponojmë në orarin zyrtar.

Për këtë arsye operatori ekonomik i interesuar do të marrë përsipër ndërrimin e biletave në sistemet e parkimit sipas kërkesës dhe lajmërimit nga Autoritetit Kontraktor.

Sasia e biletave të kërkuara nga AK është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i produkteve	Njësia	Sasia
1	Bileta elektronike për parkim tipi “Rulon”	copë	600,000
2	Bileta elektronike për parkim tipi “Fanfold”	copë	360,000

Përcaktimi i numrit të biletave të parkimit u bazua duke marrë parasysh konsumimin mesatar të biletave elektronike rulon dhe fanfold për vitin e kaluar të sheshparkimeve publike që përdorin këtë lloj bilete, për sasinë e mbetur aktuale të biletave nga blerjet e kaluara si dhe shtimin e shesheve të reja për vitin 2023 nën administrimin e Tirana Parking.

Kontraktuesi duhet të furnizojë sistemet e parkimit të instaluar në sheshparkime, parkime nëntokësore dhe terminale të autobuzave nën administrimin e Autoritetit Kontraktor sipas kërkesave të konsumit të AK, deri në ezaurimin e plotë të gjithë sasisë.

Sistemet e parkimit janë të listuara si më poshtë:

1. Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë - (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).
2. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”).
3. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (“Kompleksi Malajzian”).
4. Sheshparkimi nëntokësor – (Sheshi “Skënderbej”).
5. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Qytet Studenti”).
6. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).
7. Terminali Nr. 2 i Autobuzave të Juglindjes – (“Qytet Studenti”).
8. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Avni Rustemi”).
9. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).
10. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).
11. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).
12. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (“Bulevardi i Ri”).

13. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – ("Kopshti Zoologjik").

Më poshtë është paraqitur shpeshitia mesatare e ndërrimit të biletave elektronike për vitin 2022 dhe 3 muajt e parë të vitit 2023:

Nr.	Emërtimi	Tipi i biletës	Konsumi mesatar i kutisë/rulonit
1	Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë - (Pallati i Sportit "Asllan Rusi").	Fanfold	28 ditë
2	Sheshparkimi i automjeteve – ("Diga e Liqenit").	Fanfold	22 ditë
3	Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – ("Kompleksi Malajzian").	Fanfold	13 ditë
4	Sheshparkimi nëntokësor – (Sheshi "Skënderbej").	Fanfold	3-4 ditë
5	Sheshparkimi i automjeteve – ("Qytet Studenti").	Rulon	7 ditë
6	Sheshparkimi i automjeteve – (pranë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi").	Rulon	11 ditë
7	Terminali Nr. 2 i Autobuzave të Juglindjes – ("Qytet Studenti").	Rulon	20 ditë
8	Sheshparkimi i automjeteve – (Sheshi "Avni Rustemi").	Rulon	23 ditë
9	Parkingu Nëntokësor – (Sheshi "7 Xhuxhat").	Rulon	6 ditë
10	Parkingu Nëntokësor – (Sheshi "Italia").	Rulon	6 ditë
11	Sheshparkimi i automjeteve – (Sheshi "Selman Stermasi").	Rulon	7 ditë
12	Parkingu Nëntokësor – ("Bulevardi i Ri").	Rulon	nga dy rulona – një në 4 ditë, një në 5 ditë
13	Parkingu Nëntokësor – ("Kopshti Zoologjik").	Rulon	14 ditë

Bazuar kësaj shpeshitie, Autoriteti Kontraktor do të lajmërojë Operatorin Ekonomik në rastet kur është dhënë alarmi i gjendjes minimale të biletave nga sistemi i parkimit si dhe nga lajmëruesi i biletës për fundin e stokut. Nga ky moment Operatori Ekonomik do të ketë 2 (dy) orë kohë për të vendosur sasinë e biletave në atë sistem parkimi. Duke qenë se Tirana Parking ofron shërbim 24

orë në 7 ditë të javës, Operatori Ekonomik duhet të ketë staf të specializuar dhe të dedikuar për ofrimin e këtij shërbimi.

Në fillim të çdo muaji kalendarik do të bëhet rakordimi përkatës i vendosjes së biletave dhe shërbimit të vendosjes së tyre përgjatë muajit midis Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.